



Prishtinë, 04 tetor 2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1413\_2021

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale nr. 2065-5 ZK Rahovec me kapacitet të instaluar prej 10 kW në Komuna Rahovecit, e pranuar me nr. prot. 563/21 të datës 15.09.2021 nga aplikuesi personi fizik Sedat Rexha, me adresë: rruga "Vëllezërit Haradinaj" Komuna Rahovecit, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 04 tetor 2021 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Sedat Rexha për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale nr. 2065-5 ZK Rahovec me kapacitet të instaluar prej 10 kW në Komuna Rahovecit.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Sedat Rexha me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ 80005629 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Sedat Rexha uni do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

**A r s y e t i m**




- o ZRRE, me datë 15.09.2021 nga aplikuesi personi fizik Sedat Rexha, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale nr. 2065-5 ZK Rahovec me kapacitet të instaluar prej 10 kW në Komuna Rahovecit.
  - o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 7177 të datës 09.08.2021 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 12 Nr. 188 dt. 08.09.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikimit dhe Mbrojtje e Mjedisit e Komunës së Rahovecit.
  - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Sedat Rexha dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale nr. 2065-5 ZK Rahovec me kapacitet të instaluar prej 10 kW në Komuna Rahovecit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Rahovecit,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar